



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 437/24 Dt. 18.07.2024



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e transportit të nxënësve udhëtar për vitin shkollor 2024/2025, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për transportin (bartjen) e nxënësve udhëtar të disa shkollave fillore të Komunës së Prizrenit, në relacionin:
    - 1.1. Llokvic-Reqanë dhe anasjelltas,
    - 1.2. Drajqiç-Mushnikovë dhe anasjelltas,
    - 1.3. Gornjesell-Mushnikovë dhe anasjelltas,
    - 1.4. Tupec-Gjonaj dhe anasjelltas,
    - 1.5. Gorozhup-Planejë dhe anasjelltas,
    - 1.6. Myradem-Vlashnje dhe anasjelltas,
    - 1.7. Dobrushtë-Vermicë dhe anasjelltas.
  2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor-mallra dhe shërbime të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.
  3. Obligohet Drejtorja e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
  - Sektorit të Prokurimit,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

